



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:081773  
Datë: 13.05.2024  
Numri i dokumentit: 05675993

PAKR.nr.190/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Jeta Asllani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. B, për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj dhe mbrojtësit të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.121/23, të datës 26.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I.Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj dhe mbrojtësit të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.121/23, i datës 26.12.2023, vërtetohet.

II.Hedhet si e palejuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj, për shkelje të Kodit Penale.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krimeve të Rënda, me aktgjykimin P.nr.121/23, të datës 26.12.2023, të akuzuarin Sh. B, e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit i është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) vite dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit i është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

Në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së të akuzuarit Sh. B i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) vite e katër (4) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.03.2023 e derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

I akuzuari është obliguar që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej pesëdhjetë (50) euro, shpenzimet e procedurës penale, si në vijim, për ekspertime mjeko-ligjore, shumën prej njëzet (20) euro, plotësim i ekspertimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro, për pjesëmarrjen e ekspertit në seancë shumën prej njëqind (100) euro. Gjithashtu i pandehuri është obliguar të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro të taksës së Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të cilat është obliguar t'i paguajë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari B. B për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i armës- pistoletës me numër serik ....., me karikator dhe 5 fishekë me mbishkrimin me bazë PPU 7.62 mm TT dhe sëpatës të cilat janë sekuestruar nga i pandehuri Sh. B. Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit arma, municioni dhe sëpata duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar sa i përket vendimit mbi dënimin ta ndryshojë dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me burg efektiv më të lartë.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj, për shkak të shkeljes së Kodit Penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë sa i përket dënimit me burg, ashtu që të akuzuarin ta dënojë me burg efektiv më të lartë, si dhe të aprovohet kërkesa pasurore juridike NHGA Fondi për kompensimin e viktimave (ngase i dënuari gjendet në paraburgim dhe nuk ka mundësi me i paguar) në shumën prej: zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 27500 euro, shëmtim shumën prej 10000 euro, dhimbje fizike për lëndim të rëndë trupor shumën prej 7000 euro, frikë në rastet e lëndimeve të rënda trupore shumën prej 7000 euro.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshojë, ashtu që duke gjetur se nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë të lirohet nga aktakuza, ose aktgjykimi të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Po ashtu ka propozuar që ndaj të akuzuarit të hiqet masa e paraburgimit në mënyrë që i njëjti të mbrohet në liri.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.179/2024, të datës 26.03.2024 ka propozuar që të aprovohen si të bazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, si dhe ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj, të ushtruara kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.121/23, të datës 26.12.2023, dhe të njëjtin aktgjykim ta ndryshojë dhe t'i shqiptojë dënim me burgim më të lartë. Ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi.

Në kuptim të nenit 390 të KPPRK-së kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për datë 17.04.2024 dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar i akuzuari Sh. B, mbrojtësi i të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit dhe i dëmtuari B. B edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë theksimeve në ankesë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë paraqitur rrethana të cilat arsyetojnë shqiptimin e një dënimi më të rëndë. I dëmtuari vuan nga probleme shëndetësore si pasojë e këtij rasti. Konsiderojmë se dënimi i shqiptuar është shumë i ulët dhe nuk kanë ekzistuar arsye për zbutjen e dënimit deri në këtë pikë. Do të parashtrojmë kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë arsyetimit të ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Andaj mbetemi pranë propozimit si në ankesë.

I akuzuari Sh. B ka deklaruar se e mbështet ankesën e mbrojtësit Av. Mahmut Halimi.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPRK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj dhe mbrojtësit të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi, janë të pabazuara.

#### Pretendimet ankimore të Prokurorit të shtetit

Prokuroria Themelore në Mitrovicë pretendon që gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit ka nxjerrë konkluzion të gabuar për arsye se dënimi i shqiptuar është mjaft i butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën e kryer penale e posaçërisht pasojat konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Gjykata me rastin e matjes së llojit të dënimit ndaj të akuzuarit nuk ka vlerësuar drejt rrethanat mbi matjen e dënimit sipas dispozitave ligjore. Gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se i pandehuri është pensionist dhe i moshës së shtyrë -rreth 74 vjeçar, ka shprehur keqardhje për rastin, ndaj tij nuk janë iniciuar raste tjera penale, para e pas këtij rasti ka treguar sjellje të mira, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të tilla. Ndërsa rrethana rënduese në rastin konkret gjykata vlerësuar, shkallën e lartë të

dashjes së shprehur, se veprën e ka kryer i motivuar nga një konflikt i mëhershëm me të dëmtuarin, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial në këtë vepër penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, i cili ka shfrytëzuar situatën gjersa i dëmtuari ka qenë i vetëm në pyll, ai me sëpatë e ka sulmuar disa here të dëmtuarin në kokë, bark, shpinë dhe pjesën e krahavorit, duke i shkaktuar lëndime të shumëfishta trupore të natyrës së rëndë trupore të cilat edhe e kanë rrezikuar jetën e tij. Se i pandehuri pas sulmit nuk i ka ofruar ndihmë të dëmtuarit. I dëmtuari ka ngel i vetëm në pyll në gjendje të rëndë shëndetësore dhe në këtë mënyrë jeta e tij është vënë drejtpërdrejt në rrezik dhe se në këtë rast ka kryer dy vepra penale. Gjykata me rastin e matjes së dënimit është dashtë që t'ia fal besimin më tepër rrethanave renduese të cekura si më lartë, të cilat rrethana nuk janë vlerësuar në masën e duhur. Sikurse gjykata t'i kishte marr për bazë dhe vlerësoj në detaje këto rrethana me siguri dënimi i shqiptuar do të ishte ndryshe nga ky dënim i shqiptuar sipas aktgjykimit ankimor. Me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit nuk do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit si dhe nuk do të ndikojë tek personat tjerë që të mos kryejnë vepra penale të kësaj natyre dhe të tjera.

#### Pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, mbrojtja pretendon që gjykata e shkallës së parë nuk i ka paraqitur as në mënyrë të qartë e as në mënyrë të plotë faktet të cilat i konsideron të vërtetuara.

Në raport me ekspertizën mjeko-ligjore dhe deklarin e ekspertit Dr. F. B të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 05.12.2023, në faqen 15, pasuesi i fundit dhe në vazhdim faqen 16 të arsytimit të aktgjykimit konstatohet se sipas ekspertit lëndimi i shkaktuar në pjesën e barkut është prerje nga mjeti i mprehët e që shihet edhe nga fotografitë se buzët e plagës janë të rregullta, vijore dhe nuk përjashtohet mundësia që të jetë shkaktuar vetëm me një tërheqje, ndërsa në faqe 23 pasuesi i fundit lidhur me lëndimin në pjesën e barkut, kur gjykata refuzon pretendimet e të pandehurit se lëndimet në pjesën e barkut të dëmtuarit i janë shkaktuar gjatë përleshjes, kur i dëmtuari me dorë ia ka kap sëpatën, duke e afëruar barkut, ndërsa gjatë tërheqjes së sëpatës është shkaktuar plaga prerëse në bark. Këtë pretendim të të pandehurit gjykata e shpall të pabesueshëm e me arsyetim se sipas raportit plotësues të ekspertizës mjeko-ligjore për këtë plagë theksohet se lëndimi i të dëmtuarit në pjesën e barkut është shumë e mundshme që është shkaktuar nga veprimi i mjetit mekanik të mprehët i cili vepron me mekanizëm të tehut dhe peshës së tij, pra duhet të jetë një forcë goditëse relativisht e madhe. Ndërsa nga përmbajtja e ekspertizës dhe deklarimet e ekspertit në shqyrtimin gjyqësor, i njëjti në përgjigjen e dytë në fq.4

është deklaruar se "në qofte se dikën me jakne e godet (siç ka qenë i dëmtuari i veshur atë dite v.i) me sëpatë, më problem është me shkaktuar prerje me goditje sesa me tërheqje,... pra sipas mendimit tim është e mundur që edhe me tërheqje të sëpatës duke vepruar me teh të jetë shkaktuar prerja e jaknes gjaketës dhe plaga ne bark"? Ndërsa në vazhdim të faqes së njëjtë në pasusin e fundit është deklaruar se "siç po shihen, buzët e plagës janë të rregullta, vizore andaj nuk përjashtohet mundësia që të jetë shkaktuar vetëm me një tërheqje" dhe në fq.5 pas pyetjes së parë nga pala e dëmtuar eksperti është deklaruar "mjete i mprehtë në këtë rast tehu i sëpatës në qofte se godet direkt në bark me gjithë gjatësinë e tehut, logjikisht nuk ka mundësi me shkaktuar një plagë të tillë, logjike është që të këtë vepruar me këndin ku fillon tehu i sëpatës... duke vepruar në mënyrë transgjenike në bark, pra kjo plage është shkaktuar me prerje- me teh që mund të jetë shkaktuar nga veprimi tangjencial i tehut të sëpatës." Pra mundësia është që plaga të jetë shkaktuar me vetë tërheqje nga personi i plagosur ose nga tërheqja nga personi tjetër." Pra nga kjo që rezulton rrjedh se gjykata përkundër sqarimit te qartë të ekspertit ka ndryshuar kuptimin duke konsideruar se për të shkaktuar plagën e tillë do te duhej të përdoret një force goditëse relativisht e madhe, kundërthënie kjo ne raport me deklaratimet e ekspertit mjeko-ligjor, i cili ka dhënë shpjegimet te cilat në tërësi përputhen me përshkrimin e veprimeve te akuzuarit në momentin kur plaga në bark të dëmtuarit i është shkaktuar.

Me tutje gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se lëndimet janë te natyrës së rëndë trupore të rrezikshme për jetën e tij në çastin e shkaktimit, si dhe është thirrur se ekspertiza mjeko-ligjore ka konstatuar se lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari kanë qenë të rënda dhe të rrezikshme për jetën e tij në çastin e shkaktimit. As ky pretendim nuk qëndron askund, sepse ne asnjërin nga dy ekspertizat e kryera, e as ne deklaratën e ekspertit mjeko-ligjor të dhënë ne shqyrtimin gjyqësor ky mendim nuk është dhënë dhe nuk qëndron askund.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja pretendon që gjendja e fakteve është vërtetuar në mënyrë tejet të gabuar dhe jo të plotë. Gjukata e shkallës së parë ka mbivlerësuar deklaratën e të dëmtuarit pa gjetur ndonjë mbështetje logjike në përmbajtjen e saj. Gjersa i dëmtuari ka pretenduar se ditën kritike ka shkuar në mal për të prerë një dru të cilin pas prerjes e ka vendosur në traktorin e disa kushërinjve që kanë kaluar aty afër dhe duke u nisur pas pak është sulmuar nga i akuzuari Sh. , fakte këto të cilat as prokuroria, e as gjykata nuk e ka vërtetuar me ndonjë provë por në mënyrë abstrakte i ka besuar të dëmtuarit.

Është i gabuar pretendimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari vetëm në zyrën e prokurorit të shtetit dhe në shqyrtimin gjyqësor ka prezantuar pretendimet e njëjta, ngase siç rezulton nga deklarimi i të akuzuarit të dhënë në seancën për caktimin e paraburgimit të datës 02.04.2023, e cila duhet vlerësuar si provë ka dhënë shpjegime të shkurta lidhur me rrjedhën e ngjarjes së ditës kritike duke paraqitur pretendimet se i dëmtuari i ka dal në rrugë, ka kërkuar nga i akuzuari të kthehet prapa, se në një çast ka vërejtur të dëmtuarin duke nxjerrë revolen nga brezi në të cilën situatë me sëpatën të cilën e kishte në dorë e ka goditur në pjesën e dorës në të cilën e kishte pistoletën prej së cilës goditje të dëmtuarit i ka rënë revolja në tokë, ka filluar ta godas të dëmtuarin, nuk ka qenë në gjendje të kujtohet për vendin e goditjeve dhe pastaj e ka marr revolen e të dëmtuarit dhe fotrollën dhe ka shkuar në shtëpi. Gjykata nuk e ka analizuar deklaratën e tillë si provë të pranueshueshme.

Mbrojtja tutje thekson që duhet besuar deklaramit të akuzuarit, i cili në përgjigjen e dhënë në pyetjen e prokurorit ka deklaruar se “sikurse ta kisha goditë me sëpatë unë ja kisha këputur zorrët të gjitha, në pjesën e barkut unë nuk e kam goditur asnjëherë, por vetëm siç thash më lart kur më ka kapur sëpatën kah qyka, që e ka vendosur tek barku, duke tentuar të ma marr, aty në momentin e tërheqjes e ka goditur veten”. Po ashtu, duhet besuar deklaramit të të akuzuarit Sh. se ditën kritike nuk ka pas motiv sulmi që lidhet me konfliktin e mëparshëm, pasi që siç shprehet ai se po të kishte ndonjë motiv, brenda dy viteve ka mundur në çdo kohë të ndërmerri diçka të tillë pasi janë nga i njëjti fshat, se shumë herë janë parë e takuar në kalim por i është shmangur çfarëdo konflikti me atë.

Se i akuzuari Sh. nuk ka pasur pistoletë me vete vërtetohet edhe me faktin se po ta kishte të njëjtën shumë më lehtë do të ishte të vepronte me të sesa të përdorte sëpatën, porse ai ditën kritike kishte vetëm sëpatën e cila i kishte shërbyer për të prerë pipat e pemëve për shartim, ndërsa pistoletën e të dëmtuarit e cila kishte mbetur në tokë e kishte marr pas përfundimit të ngjarjes dhe gjithashtu arriti që nga brezi i të dëmtuarit të prente pjesën mbajtëse (vegën) për rrip të pantallonave të fotrollës së pistoletës sa ai ishte në pozitën e qëndrimit në gjunjë në mënyrë që ta përdorte si provë për të dëshmuar se pistoletë ishte e të dëmtuarit. Andaj arsyetimi i aktgjykimit që pretendon që i akuzuari ditën kritike nuk kishte me vete mjete të shartimit siç janë gërsërët e brisku dhe se me sëpatë është e pa mundur të bëhet shartimi, është shumë i gabuar pasi që i akuzuari në fakt ka deklaruar se ditën kritike ka shkuar në livadhin e marr me qera për të prerë ca degë të mollëve me qëllim që ato t'i shartoj në oborrin e shtëpisë së tij e jo që t'i ketë dërguar lopët në kullose siç pretendon arsyetimi i aktgjykimit.

Prandaj është i gabuar, përkatësisht i vërtetuar në mënyrë jo të plotë arsyeimi i aktgjykimit se kinse i akuzuari disa herë të birit të dëmtuarit i është drejtuar se do ta vras të dëmtuarin, sepse pretendimin e tillë gjykata nuk e ka vërtetuar me asnjë dëshmi apo provë që do të vërtetonte se i dëmtuari kishte denoncuar pranë organeve të ndjekjes kanosjen apo kanosjet e tilla, siç nuk ka vërtetuar as faktin se i dëmtuari rastësisht ka shkuar në mal dhe e ka prerë një dru dhe se atë nëse e ka prerë apo jo dhe a e ka prerë atë në malin e të afërmeve të tij apo jo, ngase me asnjë provë nuk janë vërtetuar pretendimet e të dëmtuarit.

Po ashtu sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke pretenduar që si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit tejet të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit. Prandaj konsideroj se në kuadër të provave të administruara duhet aplikuar instituti i mbrojtjes së nevojshme në kuadër të të cilët i akuzuari duhet liruar nga akuza konform dispozitës së nenit 363 të KPPRK-së ose në rastin më të pavoritshëm të bëhet ri cilësimi i veprës në drejtim të kualifikimit ligjor të lidhur me institutin e tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme nga neni 12 par.4 të KPRK-së. Në veprimet e të akuzuarit nuk është manifestuar dashja për të privuar nga jeta të dëmtuarin. Nëse i akuzuari kishte me vete pistoletën në pronësi të tij për ta zbrapsur sulmin eventual të të dëmtuarit më të lehtë do ta kishte të evitonte atë sulm me përdorim të saj dhe të i sjellë edhe pasoja fatale. Por e vërteta qëndron në faktin se pistoletën ja ka marrë të dëmtuarit pas përfundimit të ngjarjes, se i njëjti pavarësisht se ka pasur mundësi në vazhdim për shkak të humbjes së fuqisë për të rezistuar nga i dëmtuari, ta vazhdoi sulmin deri në përfundimin e aktit të vrasjes, prandaj këto veprime duhet kualifikuar në kuadrin e elementit konstitutiv të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 të KPRK-së.

Sa i përket vendimit lidhur me dënimin mbrojtja thekson që e konsideron të hershme të paraqes vlerësimet e rrethanave të cilat do të ndikonin në llojin dhe lartësinë e dënimit. Megjithatë në rast të vlerësimit se nuk qëndrojnë shkeljet e lartpërmendura në aktgjykimin e ankimuar, konsideroj se gjykata e shkallës së parë në anën e të akuzuarit ka vlerësuar shkallën e lart të dashjes së të pandehurit, e që siç u fol më sipër ai ka ndërmarr veprime në drejtim të evitimit të sulmit të atëçastshëm dhe në momentin kur rreziku i sulmit ka pushuar nga i dëmtuari, i akuzuari është larguar nga vendi i ngjarjes, nuk është saktë as rrethana se i akuzuari veprën penale e ka kryer i motivuar nga një konflikt i mëhershëm me të dëmtuarin sepse të njëjtët jetojnë në fshatin



Koshtovë, janë takuar dhe asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë fërkim eventual që do të justifikonte veprimin nga ana e të akuzuarit. Ndërsa në anën e të akuzuarit ekzistojnë rrethana lehtësuese ngase i njëjti është në moshë relativisht të shtyrë 74 vjeçar, se ka shprehur pendim dhe keqardhje për rastin e ndodhur, vuan nga sëmundja e diabetit dhe kardiake, se kurrë në jetën e tij nuk është përgjigjur për ndonjë vepër penal, se gjatë tërë rrjedhës së procedurës në këtë çështje penale ka treguar sjellje të mira, rrethana të cilat justifikojnë një dënim sa më të butë me të cilin në tërësi do të realizohet qëllimi i dënimit.

Lidhur me ankesën e Prokurorit të shtetit të ushtruar kundër aktgjyqimit të shkallës së parë për bazën juridike të vendimit lidhur me sanksionin penal duke kërkuar që të akuzuarit t'i ashpërsohet dënimi me burg, mbrojtja thekson që prokurori i shtetit nuk ka specifikuar asnjë rrethanë të veçanet e cila do të justifikonte ndonjë dënim më të ashpër, andaj ka propozuar që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar.

#### Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar B. B, Av. Kadri Osaj

Lidhur me shkeljen e kodit penal, përfaqësuesi i palës së dëmtuar thekson që nëse trupi gjykues do të rikualifikonte veprën penale të kualifikuar nga prokuroria si Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së do të tejkalonte aktakuzën, mirëpo prapë se prapë konsideroj që duke marr parasysh rrethanat i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par.1, nënpar.1.4 dhe 1.8 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Nga administrimi i provave në seancat e shqyrtimeve kryesore dhe vlerësimit të tyre në aspektin specifik ligjor dhe faktik, i akuzuari Sh. B me dashje ka manifestuar mizori, dinakëri, hakmarrje të paskrupullt dhe se me manifestimin e këtyre elementeve të veprës penale dëshmohet se është kryer vepra penale. Manifestimi i këtyre veprimeve bazohet në rrëfimin e plotë dhe jo kundërthënës të dëmtuarit-dëshmitarit B. I, dëshmitarit H. I, dëshmitarit B. J, dëshmitarit H. S, ekspertiza e ekspertit mjekoligjor e Dr. F. B, deklarami i ekspertit në seancat e shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu ka deklaruar që gjendja shëndetësore e të dëmtuarit është shumë e rëndë, ashtu që vazhdimisht është obliguar të bëjë kontroll mjekësor dhe është shtrirë në spital prej datës 23.03.2024 deri me datë 29.02.2024.

Sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal, përfaqësuesi i palës së dëmtuar thekson që trupi gjykues nuk ka marr parasysh rrethanat rënduese gjatë shqiptimit të dënimit dhe se me dënimin e tillë nuk do të ndikojë tek i dënuari dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepër penale të kësaj natyre dhe të tjera. Duke u bazuar në konstatimin e ekspertit se kemi të bëjmë me lëndime

të rënda trupore dhe duke u bazuar në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 27.02.2023 është bërë kërkesa pasurore juridike.

### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

#### Të gjeturat për pretendimet ankimore lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtësit të akuzuarit Sh. B, Av. Mahmut Halimi, sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë, e gjithashtu nuk ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e këtij aktgjykimi. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni të plotë me arsyetimin, ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit janë formësuar elementet e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka analizuar të gjitha provat e procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e saj, e të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i vlerëson edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPPRK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprave penale nga ana e të akuzuarit.

#### Të gjeturat për pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Sh. B është kryes i veprave penale për të cilat është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Sh. B në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, i ka kryer veprat penale për

të cilat është shpallur fajtor, nga fakti se më datë 31.03.2023, rreth orës 14:15 minuta, në fshatin Koshtovë, komuna e Mitrovicës, në rrugë të pyllit, në vendin e quajtur “Kodra e Ramës”, me dashje dhe me qëllim që të privojë nga jeta të dëmtuarin B. B, i pandehuri me sëpatë e ka sulmuar dhe e ka godit të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit, në kokë, në shpinë dhe në anën e majtë të barkut. Si pasojë e këtyre goditjeve, i dëmtuari ka pësuar lëndime trupor, plagë shqyese depërtuese në regjionin e majtë të barkut, në regjionin muror të majtë të kokës dhe në gishtin I-të dorës së majtë, thyerje serike e brinjëve IV-IX të anës së majtë të kraharorit dhe shpatullës së majtë, ndrydhje dhe gjakmbledhje nënlekuore të shumta në të dya nët e regjionit i dorës së majtë dhe zgavrës së barkut të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë (sëpatës), të cilat bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore të rrezikshme në castin e shkaktimit për jetën e tij. Gjithashtu gjerë me datë 31.03.2023, rreth orës 15:00, në kundërshtim me ligjin për armët e ka mbajtur në posedim armën pa leje përkatëse, armën- gjysmë automatike Norcio, modeli Type 54 e kalibrit 7.62x25mm, me numër serik ...., me karikator dhe pesë 5 fishekë, me mbishkrimin me bazë PPU 7.62 mm TT, e cila armë është gjetur dhe sekuestruar nga policia gjatë bastisjes në rrobat e të pandehurit Sh. B.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave, siç janë: deklarimi i të dëmtuarit- dëshmitarit B. B, si dhe dëshmitarëve H. B, H. S, B. J, deklarimi i ekspertit mjekoligjor Dr. F. B, si dhe provat materiale si: gjashtë (6) raportet policore të datës 31.03.2023, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 31.03.2023, raporti mjekësor në emër të dëmtuarit B. B, fletëlëshimi i spitalit të përgjithshëm “Dr. Sami Haxhibeqiri”, në Mitrovicë, me numër të amzës ..., i datës 10.04.2024, në emër të dëmtuarit B. B, Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, AKF/2023-1394/23-1291 të datës 23.05.2023, ekspertiza mjekoligjore e datës 15.05.2023 e Dr. F. B, në emër të dëmtuarit B. B, fotoalbumi i datës 31.03.2023, fotografitë në origjinal në kolor ku shihen plagët e të dëmtuarit të rënditura me numër 1 deri në 5, Raporti plotësues i ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. B, i datës 26.10.2023, dy fotografi të këllëfit të armës të sekuestruar nga i pandehuri, kallëzimi penal i policisë i datës 25.03.2022 dhe vendimi i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nr. PP.II.nr.932/2022, i datës 08.06.2022

Andaj pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë tejet të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike, pasi e ka mbivlerësuar deklaratën e të dëmtuarit pa gjetur mbështetje logjike dhe pa u vërtetuar me ndonjë provë, janë të pabazuara, pasi gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara, përkatësisht dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat

materiale me të drejtë ka vërtetuar faktin se i akuzuari e ka sulmuar të dëmtuarin për shkak të konfliktit të mëhershëm në mes tyre. Ky fakt bëhet i besueshëm duke pas parasysh rrethanat se i akuzuari ka refuzuar të pajtohet me të dëmtuarin përkundër të gjitha përpjekjeve të ndërmjetësuesve të cilët ishin angazhuar nga i dëmtuari për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, fakt të cilin e kanë konfirmuar të gjithë dëshmitarët, i dëmtuari, e që as vet i akuzuari nuk e ka mohuar. Gjithashtu edhe i akuzuari është shprehur se e ka përjetuar rëndë ngjarjen dhe konfliktin e mëhershëm. Sulmi me sëpatë ndaj të dëmtuarit tregon qartë dashjen e shprehur për të privuar nga jeta të dëmtuarin. I akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se veprimet e tij, përkatësisht sulmi dhe goditjet ndaj të dëmtuarit me sëpatë mund të shkaktojnë pasoja të paparashikueshme dhe mund t'ia rrezikojnë jetën. Dashja e tij e plotë ka ekzistuar që në momentin e përdorimit të mjetit të përshtatshëm (sëpatës) për sulm, pastaj me fillimin dhe vazhdimin e sulmit, goditjet e shumëfishta dhe të përsëritura ndaj të dëmtuarit në pjesët vitale, pavarësisht qëndrimit të tij të mëvonshëm apo mundësisë që me mjete tjera ta qoj deri në fund përpjekjen e tij. Po ashtu fakti që i akuzuari është larguar nga vendi i ngjarjes dhe e ka lënë të dëmtuarin në gjendje shumë të rëndë pa asnjë lloj ndihme.

Ndërsa fakti se i pandehuri e ka mbajtur pa leje armën dhe municionin për një kohë pacaktuar, vërtetohet pasi me rastin e arrestimit policia ia kanë gjetur dhe sekuestruar armën me numër serik ..., me karikator dhe pesë 5 fishekë, me mbishkrimin me bazë PPU 7.62 mm TT, e që në raportin e policisë nuk evidentohet ndonjë pretendim i të pandehurit apo mohim i tij mbi pronësinë e armës.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

#### Të gjeturat për pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal

Kolegji penal i kësaj gjykate i vlerëson si të pabazuara pretendimet lidhur me shkeljen e ligjit penal, pasi nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e KPPRK-së të cilat konsiderohen shkelje e ligjit penal, në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat i njëjti është shpallur fajtor, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të akuzuarit.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit për faktin se në këtë rast duhet aplikohet instituti i mbrojtjes së nevojshme, Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se një pretendim i tillë nuk qëndron dhe gjykata e shkallës së parë drejt ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbushën kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Si kusht primar për ekzistimin e mbrojtjes së nevojshme duhet të ekzistojë sulmi. Ndërsa nga provat e administruara nuk është arritur të provohet se i dëmtuari e ka sulmuar të pandehurin, se i dëmtuari ka poseduar armë zjarri, se i dëmtuari ia ka drejtuar armën të pandehurit dhe i pandehuri ka arritur t'ia marr armën e tij. Ndërsa në anën tjetër i pandehuri nuk ka pësuar asnjë lëndim trupor e as një gërvishtje të vetme në këtë rast.

#### Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar për një dënim më të lartë dhe ato të mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat në mbështetje të dispozitës së nenit 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese janë vlerësuar shkalla e lartë e dashjes së shprehur nga i akuzuari, përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e tij e plotë, kontributin esencial të vepra penale, mënyrë e kryerjes së veprës penale, ashtu që i pandehuri e ka shfrytëzuar situatën gjersa i dëmtuari ka qenë i vetëm në pyll, me sëpatë e ka goditur disa herë të dëmtuarin në kokë, në bark, në shpinë dhe në pjesën e kraharorit, duke i shkaktuar lëndime të shumëfishta trupore të natyrës së rëndë trupore të cilat ia kanë rrezikuar jetën e tij, se pas sulmit i pandehuri nuk i ka ofruar asnjë ndihmë të dëmtuarit, i dëmtuari ka ngel në pyll i vetëm në gjendje të rëndë shëndetësore dhe në këtë mënyrë jeta e tij është vënë drejtpërdrejt në rrezik dhe në këtë rast ka kryer dy vepra penale. Ndërsa si rrethana lehtësuese janë vlerësuar fakti se i akuzuari është pensionist dhe i shtyrë në moshë rreth 74 vjeç, ka shprehur keqardhje prej rasti, ndaj tij nuk janë iniciuar raste tjera penale, para as pas këtij rasti, ka treguar sjellje të mira, nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale dhe më parë nuk ka qenë i dënuar, ka premtuar që të ardhmen nuk do të përsërisë sjellje të tilla. Duke i pasur parasysh rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindjen se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Një vlerësim të këtyre rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pastaj fakti se në ankesën e Prokurorit nuk ceket ndonjë rrethanë rënduese që do të justifikonte shqiptimin e një dënimi më të ashpër, ndërsa disa nga rrethanat në

të cilat thirret mbrojtësi i të akuzuarit Sh. B veç se kanë qenë objekt gjykimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe pikërisht si rezultat i këtyre rrethanave të akuzuarit i është shqiptuar dënimi nën minimumin e paraparë ligjor, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjyqimit të ankimuar. Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjyqimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund i pandehuri nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

#### Të gjeturat lidhur me kërkesën pasurore juridike

Gjykata e Apelit vlerëson së gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar pjesërisht kërkesën pasurore juridike vetëm sa i përket bazës sa saj, duke u bazuar në atë se është fakt i pakontestueshëm se i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, si pasojë e sulmit nga i pandehuri, e kjo bazuar në akt ekspertimin mjekoligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe në mendimin e paraqitur nga eksperti mjekoligjor Dr. F. B, si dhe në bazë raporteve mjekësore nga institucionet shëndetësore publike, dëshkohet se i dëmtuari ka pranuar trajtim mjekësor, shkak i lëndimeve që ka pësuar si pasojë e sulmit dhe goditjeve nga i pandehuri. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë sa i përket shumës dhe lartësisë së dëmit, të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontest civil për shkak se nuk ka dëshmi të përcaktuar me saktësi shumën dhe lartësinë e dëmit që ka pësuar i dëmtuari. Andaj në mungesë të këtyre dëshmive, është e pamundur që në këtë procedurë të vërtetohet për lartësinë e dëmit të pësuar nga i dëmtuari.

#### Të gjeturat lidhur me pikën II të dispozitivit të këtij aktgjyqimit

Sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjyqimit, Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit B. B, Av. Kadri Osaj, në pjesën e ushtruar për shkeljen e Kodit Penal, është e palejuar, pasi është ushtruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 381 par. 3 të KPPRK-së, në të cilën dispozitë shprehimisht theksohet se në cilat raste i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë. Sipas kësaj dispozite, i dëmtuari mund të ushtrojë ankesë vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale për trafikimin me qenie njerëzore, dhunën në familje, veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për kërkesën pasurore juridike kur i akuzuari shpallet fajtor, si dhe shpenzimet

e procedurës penale që ndërlidhen me të, e jo edhe për rastin konkret siç ka vepruar përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PAKR.nr.190/2024

Datë: 17.04.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

\_\_\_\_\_

Jeta Asllani

\_\_\_\_\_

Kadrije Goga Lubishtani

\_\_\_\_\_

Hashim Çollaku

\_\_\_\_\_

Xhevdet Abazi